




**Komisioneri Regulativ i Prokurimit Publik**  
Regulatorna Komisije Javne Nabavke  
Public Procurement Regulatory Kommission



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS  
AUTORITET KOSOVA ZA  
KONKURENCIJU  
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY



**Marrëveshje Bashkëpunimi  
ndërmjet  
Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik  
dhe**



## Autoritet Kosovar të Konkurrencës

## Neni 1 Qëllimi

Kjo marrëveshje ndërmjet Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për qëllim kryesor ka vendosjen dhe definimin e roleve, përgjegjësive dhe procedurave për ngritjen të bashkëpunimit ndërinstitucional të dy institucioneve si pale të interesit në prokurimin publik, për të siguruar zbatimin e vazhdueshëm dhe të duhur të kornizës rregullative të prokurimit publik dhe të mbrojtjes së konkurrencës.

1. KRPP është përgjegjës për bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik, interpretimin e kornizës legjislative në fushën e prokurimit publik, trajnimet si dhe ka mandat që të administroj dhe udhëheqë të gjitha shërbimet e TI-së që janë në funksion të përdorimit, operimit dhe funksionimit të sistemit te prokurimit elektronik, sistem në të cilin zhvillohen të gjitha aktivitetet e prokurimit nga autoritetet kontraktuese,  
dhe
  2. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është përgjegjës për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Autoriteti ka kompetencia e përcaktuara në këtë ligj dhe ligjin për procedurën e përgjithshme administrative mbi bazën e të cilëve inicon hetime, kryen inspektime në terren, vendosjen e gjobave dhe masave për rikthimin e konkurrencës së lirë në treg, si dhe ndalimin e bashkimeve kundër konkurrencës.

**Neni 2**  
**Palët**

- I. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (në tekstin e mëtejmë "KRPP"), në adresë Ndërtesa e Gërmisë, Zona B, Sheshi Nëna Terezë, ndertës e ish Gërmisë, 1000 Prishtinë, të cilën e përfaqëson Z. Osman Vishaj, Kryetar i Komisionit Rregullativ i Prokurimit Publik;
- II. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (në tekstin e mëtejmë "AKK"), në adresë Rr. Migjeni, katë VI, Ish objekti i bankës së Lubjanës, 10000 Prishtinë, e përfaqëson Znj. Neime Binaku - Isufi, Kryetare e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

**Neni 3**  
**Obligimet e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik**

1. Për qëllimin e specifikuar në nenin 1, paragrafi 2, KRPP zotohet që për zyrtarët e AKK, të ofroj ndihmë teknike, këshilla dhe interpretime me shkrim në lidhje me për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të Ligjit për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejmë "LPP"), dhe çdo dokumenti të nxjerrë nga KRPP-ja.
2. Për qëllimin e specifikuar në nenin 1, paragrafi 2, KRPP zotohet që për zyrtarët e AKK (sipas kërkesave te bëra dhe nevojave te paraqitura), të ofroj punëtori dhe trajnime në mënyrë që të përforcojë vetëdijen në mesin e zyrtarëve të AKK-së për legjislacionin e prokurimit publik si dhe objektivat, procedurat dhe metodat e tij.
3. Për qëllimin e specifikuar në nenin 1, paragrafi 2, KRPP zotohet që për zyrtarët e AKK-së të ofrojë qasje të dedikuar në sistem të prokurimit elektronik, qasje e cila do të mundësojë disponueshmëri në kohë reale të të dhënavë të aktiviteteve të prokurimit.
4. Qasja e dedikuar në sistem të prokurimit elektronik do të realizohet nga KRPP nëpërmjet regjistrimit të një njësie organizative të veçantë në sistem të prokurimit elektronik me emërtimin (AKK ose të ndonjë Departamenti/njësie të veçantë të AKK) dhe regjistrimin e një përdoruesi në kuadër të Sekretariatit të AKK-së.
5. KRPP zotohet që çdo qasje e zyrtarëve të AKK-së në sistem të prokurimit elektronik të mbetet e pa evidentuar nga ana e zyrtarëve të autoritetetë kontraktuese, dhe do jetë në dispozicion vetëm të KRPP-së.
6. KRPP zotohet që pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje të ofroj trajnime dhe udhëzime për zyrtarët e AKK-së lidhur me përdorimin e llogarisë dhe nxjerrjen e të dhënavë të këruara sipas autorizimeve.
7. KRPP zotohet që të ofrojë asistencë teknike të dedikuar në zgjidhjen e problemeve teknike të shfaqura për zyrtarët e AKK-së gjatë përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik.

**Neni 4**  
**Obligimet e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës**

1. AKK, me nënshkrimin e kësaj marrëveshje dakordohet me zgjidhjen e ofruar dhe realizuar nga KRPP mbi qasjen e dedikuar për qëllime të specifikuar ne nenin 1, paragrafin 2.

- AKK obligohet që të emëroj/caktoj së paku një zyrtar në emër të të cilit do të regjistrohet llogaria për qasje të dedikuar.
- AKK zotohet që përdorimi i llogarisë dhe qasjes së dedikuar do të përdoret vetëm për qëllime të nxjerrjes së të dhënave të prokurimit sipas autorizimeve përkatëse, siç është përcaktuar nenin 1, paragrafi 2, dhe se përdorimi i llogarisë do jetë në pajtueshmëri me politikat dhe procedurat e sigurisë së informacionit për platformën e prokurimit elektronik të aprovuara nga KRPP.
- AKK, respektivisht Sekretariati obligohet që të përcaktojë rregullat dhe procedurat e brendshme për përdorimin e qasjes së dedikuar në sistem të prokurimit elektronik, varësisht nga autorizimet e ndërlidhura me raste të caktuara.
- AKK obligohet që të caktojë zyrtarët pjesëmarrës në trajnim të ofruar nga KRPP për përdorimin e llogarisë së sistemit të prokurimit elektronik.
- Përdoruesit e AKK-së obligohen që çfarëdo problemi teknik të shfaqur gjatë përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik, ta raportojnë në KRPP tek zyrtari i KRPP-së i dedikuar për komunikim lidhur me këtë qasje të dedikuar.

**Neni 5  
Mënyra e bashkëpunimit**

- Për të lehtësuar zbatimin e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, KRPP dhe AKK do të emërojnë zyrtarët përgjegjës, siç është specifikuar në nenin 2 dhe 3 të kësaj marrëveshje:
  - Personi përgjegjës nga KRPP: Vlora Kuqi
  - Personi përgjegjës nga AKK: Selajdin Beqa

**Neni 6  
Ndërprerja**

- Palët mund të përfundojnë pjesëmarrjen e tyre në këtë marrëveshje, duke i dhënë njoftim me shkrim prej një muaji partnerit zbatues dhe Palës tjetër, në rrethanat kur palët vlerësojnë që obligimet dypalëshe të specifikuara në këtë marrëveshje nuk janë në funksion të qëllimit të marrëveshjes, ose në rastet kur bëhet e pamundur një marrëveshje e tillë si pasojë e legjispcionit në fuqi.

**Neni 7  
Kopjet e marrëveshjes**


- Marrëveshja nënshkruhet në dy kopje identike, nga një për secilën Palë.

**Neni 8  
Dispozitat e fundit**

- Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga Palët dhe do të jetë në fuqi deri në ndërprerjen e saj, siç është specifikuar në nenin 6.


2. Marrëveshja e bashkëpunimit mund të plotësohet apo të ndryshohet me marrëveshje me shkrim mes dy palëve.
3. Çdo mosmarrëveshje lidhur me zbatimin e kësaj marrëveshje bashkëpunimi do të zgjidhet në mes palëve me negociata dhe me marrëveshje shtesë.

Për: Komisionin Rregullativ të  
Prokurimit Publik



z. Osman Vishaj  
Kryetar

Për: Autoritetin Kosovar të  
Konkurrencës



zpj. Neime Binaku-Isufi  
Kryetare

Vendi: Prishtinë

Datë: 26/09/2022